



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:209609

Datë: 22.08.2024

Numri i dokumentit: 06076526

KPPP.nr. 1126/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit "ICON 2022" SH.P.K., me numër unik të identifikimit 811940875, me seli në Prishtinë rr "Qamil Hoxha", nr.30, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.358/24 të datës 08.05.2024 të Përmbaruesit Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 22.08.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit "ICON 2022" SH.P.K., dhe Urdhri Përmbarimor P.nr.358/24 i lejuar me datë 08.05.2024 nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.358/24 të datës 08.05.2024, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit përmbarimor– Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.01/56-26/2024-GJ të datës 03.01.2024 me të cilin ka urdhëruar debitorin që t'ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 1,200.00€ (një mijë e dyqind euro) me kamatë ligjore duke filluar prej paraqitjes së propozimit për ekzekutim, deri në pagesën përfundimtare, me ndalim të qarkullimit të mjeteve në xhirollogarinë e debitorit dhe llogarive tjera ndihmëse në BPK, ose pasurisë së debitorit deri në bartjen e shumës së cekur më lartë në xhirollogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi urdhrin përmbarimor, duke theksuar se urdhri për përmbarim është i pabazuar, palejuar dhe i paqëndrueshëm për faktin se nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore. Më tutje debitori

thekson se Vendimi Nr.01/56-26/24-GJ i datës 03.01.2024 për momentin nuk është dokument përmbarues, pra nuk paraqet titull ekzekutiv. Më tutje thekson se Vendimi i Inspektoratit të Punës është marrë me shkelje të shumta dhe ka dëmtuar debitorin në masë të madhe, duke mos i dhënë asnjë afat ligjor që debitori të mund të kryej ekzekutimin e pagave. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, dhe të shfuqizoj Urdhrin Përmbarimor P.nr. 358/24 të datës 08.05.2024

Kreditori brenda afatit ligjorë ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilën ka kundërshtuar pretendimet e debitorit me arsyetimin se të njëjtat janë të pabazuara në dispozitat ligjore. Tutje ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se dokumenti nuk ka titullin ekzekutiv meqenëse Inspektorja e Punës ka vepruar konform kompetencave dhe autorizimeve me ligj dhe ka proceduar tutje masën ndëshkuese. Më tutje ka theksuar se organi i përmbarimit është kompetent në këtë rast të bëjë përmbarimin e vendimit të masës ndëshkuese dhe se procedura është zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së, si dhe Inspektorët e punës i kanë zbatuar dispozitat ligjore në mënyrë të drejtë. Më tutje ka shtuar se mbeten në tërësi pranë theksimeve të paraqitura në vendimin e Inspektorëve të punës. Andaj, gjykatës i propozon që të refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të lë në fuqi urdhrin përmbarimor, P.nr.358/24, i lejuar me datë 08.05.2024, nga Përmbaruesi Privat Rezarta Metaj.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka vlerësuar dokumentin përmbarimor Aktvendimin Nr.01/56-26/24-GJ i datës 03.01.2024, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafit 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Po ashtu Aktvendimi Nr.01/56-26/24-GJ i datës 03.01.2024, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr.01/56-26/24-GJ i datës 03.01.2024, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi Nr.01/56-26/24-GJ i datës 03.01.2024, i nxjerrë nga Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë të datës 21.02.2024.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1126/24, datë 22.08.2024

Gjyqtari  
Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.